POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Braktisi bashkëshortin me dy fëmijët e mitur për të dashurin, gjendet nga 'Pa Gjurmë' në Tiranë Esmeralda Pura: Mora atë që desha! Apeli i nënës: Kthehu për fëmijët, të kemi falur

2 Mbërrijnë në Kiev tre liderë evropianë, kryeministrat e Polonisë, Sllovenisë dhe Republikës Çeke

3 Humbja e thellë e PD më 6 mars, Patozi: Përgjegjës Basha e Berisha, e katandisën partinë në shifra minimale! Nuk kanë ndërmend të largohen, demokratët t'i bëjnë presion

4 Rusët po vrasin gazetarë në Ukrainë, humbin jetën në një sulm fotoreporteri i 'FOX News' dhe gazetarja ukrainase! Korrespondenti i plagosur rëndë

5 Vendimi i arsyetuar/ 'Kushtetuesja' për mos shkarkimin e Metës: Presidenti jo në lartësinë e duhur, gjuhë agresive dhe jetë aktive politike! Por veprimet nuk sollën pasoja




Kronikë

# Trafikonin kapsolla, arrestohen 3 të rinj në Durrës, sekuestrohen 2000 copë dhe veshje me simbolet e policisë

*Policia e Durrësit ka vënë në pranga 3 persona, pasi janë kapur duke shitur kapsolle elektrodetonatore.*

Redaksia
15 Mars, 09:07 | Përditesimi i fundit: 15 Mars, 09:13

Policia e Durrësit ka vënë në pranga 3 persona, pasi janë kapur duke shitur kapsolle elektrodetonatore.

Të arrestuarit janë identifikuar si Arif Qerimaj, 32 vjeç, lindur dhe banues në Përmet; Xhem Vakaj 22 vjeç, i dënuar më parë dhe një 18-vjeçare, të dy banues në Durrës.



LEXO EDHE:
**Rritja e çmimit të naftës, peshkatarët në Durrës: Do shtrenjtohen produktet e detit**

Xhem Vakaj dhe 18-vjeçarja po qarkullonin me një automjet tip “Audi”, me të cilin kanë shkuar te Shkëmbi i Kavajës, ku i priste shtetasi Arif Qerimaj, i cili kishte ardhur nga Përmeti dhe kishte me vete një çantë krahu dhe një kuti kartoni brenda të cilave kishte pako me kapsolla elektrodetonatore, gjithsej 2000 copë. Në momentin e shkëmbimit të kapsollave, të rinjtë janë kapur nga policia.

Gjatë kontrollit fizik, Xh. V. i është gjetur edhe një thikë.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar 2000 kapsolla elektrodetonatore, një xhaketë dhe një pulovër si ato të Policisë, me simbole të Policisë, një kapuç, një thikë, automjeti tip “Audi” dhe 4 aparate celulare.

Në bashkëpunim me Prokurorinë vijon puna për zbardhjen e plotë të këtij rasti.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për hetime të mëtejshme, për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, “Mbajtja pa të drejtë e uniformës” dhe “Trafikimi i armëve dhe i municionit”.

J.GJ./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Arrestime | kapsolla | Durres | Xhem Vakaj | Arif Qerimaj

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Jeni pro apo kundër protestave për rritjen e çmimeve?**

Pro | Kundër | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kosova & Rajoni

Kosovë, arrestohen 48 policë të kufirit për ryshfet dhe shpërdorim detyre, të përfshirë dhe efektivë nga Shqipëria
14 Mars, 13:46

Kronikë


Gjykata e Lartë e ka shpallur të pafajshëm, policia e Elbasanit e arreston, e mban në burg prej 24 orësh
Arsen Rusta
14 Mars, 12:08

Kronikë


Grabitën lokalin në Kavajë dhe kanosën me armë pronarin që të mos kallëzonte krimin, arrestohen 2 hajdutët, autorë të disa vjedhjeve të tjera
14 Mars, 09:20

Kronikë

Po kalonin me furgon 4735 kg ‘Guda’ kontrabandë në Qafëbotë për ta tregtuar në Shqipëri, arrestohen 3 presona, njeri prej tyre doganier
13 Mars, 18:01

Kronikë

Nis protesta edhe në Durrës, bllokohet rruga tek 'Stacioni i Trenit'
11 Mars, 17:17

Kronikë


Durrës, mashtronin të huaj përmes Call Center, në pranga 36-vjeçari, nën hetim 3 të tjerë
11 Mars, 11:49

Kronikë

Protestat për rritjen e çmimeve në të gjithë vendin, 30 të arrestuar, 118 nën hetim, 15 në kërkim
11 Mars, 09:20

Sociale

VIDEO/ Rritja e çmimit të naftës, qytetarët ngrihen në protestë në Durrës, bllokojnë rrugën pranë stacionit të trenit
10 Mars, 17:16

Kultura

Përcillet për në banesën e fundit “bilbili i këngës” durrsake, Qemal Kërtusha
Aldo Mustafa
10 Mars, 16:48

Kronikë


EMRAT/ SPAK godet 5 grupe kriminale të trafikut të drogës! Aksion në 6 qytete të vendit, priten 44 masa-arresti! 33 në burg, mes tyre dy efektivë policie
10 Mars, 08:33

Sociale

Rritja e çmimit të naftës, durrsakët fikin makinat në rrugë në shenjë proteste
9 Mars, 18:36

Kronikë


Dhjetëra të vdekur në rrugën Thumanë-Tapizë, eksperti i sigurisë Sulçe: Shkak i aksidenteve parakalimi i gabuar, shumë makina në një rrugë të ngushtë
Julian Shota
Sokol Dema
9 Mars, 15:26



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje